



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1740/9 prot

Datë 09.08.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1016/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 09.08.2024 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “General Plus” SHPK, “Biotek” SHPK dhe “Alma Kodra” PF në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-06297-05-23-2024, me objekt “Blerje rrota per kazane”, me fond limit 1.702.800 (një milion e shtatëqind e dy mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
- Autoriteti Kontraktor:** Eco Tirana sha  
Adresë: Rruga “Don Bosko”, ish parku i autobusave, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK, me NIPT M113130290, me adresë: Rruga “Ndre Mjeda” Kompleksi “Magnet”, Tiranë.
- Subjektë të Interesuara:** Operatori ekonomik “General Plus” SHPK me NIPT L82020015J, me adresa: Komuna Parisit, Pall. 6, Shk. 2, Ap. 25, Tiranë.

Operatori ekonomik “Biotek” SHPK, me NIPT L82203011N, me adresë: Rruga “Migjeni”, Pallati Raiffeisen Bank, shkalla 1, dyqani 13, Tiranë.

Operatori ekonomik “Alma Kodra” PF, me NIPT K32725211G, me adresë: Lagjia “Haxhias”, Elbasan.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.05.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-06297-05-23-2024, me objekt “*Blerje rrota per kazane*”, me fond limit 1.702.800 (*një milion e shtatëqind e dy mijë e tëtëqind*) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.

II.2. Në datën 18.06.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 18.06.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                        |           |      |             |
|------------------------|-----------|------|-------------|
| 1. “General Plus” SHPK | 1,534,500 | lekë | kualifikuar |
| 2. “Biotek” SHPK       | 1,566,000 | lekë | kualifikuar |
| 3. “Alma Kodra” PF     | 1,575,000 | lekë | kualifikuar |
| 4. “Bajro Bros” SHPK   | 1,665,000 | lekë | kualifikuar |

II.4. Në datën 27.06.2024, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim - Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “*General Plus*” SHPK.

II.5. Në datën 28.06.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4266, si dhe nr. protokollit 1740/2024, datë 28.06.2024, e operatorit ekonomik “*Bajro Bros*” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “*General Plus*” SHPK, “*Biotek*” SHPK dhe “*Alma Kodra*” PF, në procedurën e mësipërme të prokurimit me përmbajtje si më poshtë vijon:

*OE - GENERAL PLUS, nuk ploteson kerkesen 2.4.4 te DT, pasi mostrat e paraqitura nga ky OE nuk ploteson specifikimet teknike te DT, konkretisht: Pesha e Rrotes me frene eshte me e vogel se 3170 gr dhe trashesia e rrotes me frene eshte me e vogel se 50 mm, dhe Pesha e Rrotes pa frene eshte me e vogel se 3040 gr dhe trashesia e rrotes pa frene eshte me e vogel se 50 mm. Gjithashtu OE - GENERAL PLUS, nuk ploteson kerkesen 2.4.1 te DT, pasi autorizimi i prodhuesit i paraqitur nga ka OE nuk eshte nga prodhuesi i rrotave por nga shitesi i tyre dhe nuk vertetohet me dokument lidhja e shitesit me prodhuesin. Gjithashtu: Perpara shpalljes perfundimtare te njoftimit te fituesit, OE -GENERAL PLUS, duhet te dorezonte prane AK, pervec dokumentacionit te dorezuar ne SPE edhe dokumentat e meposhtme provuese te deklarimeve ne formularin e vetedeklarimit, ne origjinal ose te njehesuara me origjinalin:*

*A- Ne perputhje me piken A te Pjeses II - shkaqet e perjashtimit:*

*1- Ekstraktin e thjeshte dhe historik te Regjistrit tregetar - paragrafi i pare dhe paragrafi i*

*peste.*

2- Vertetim nga gjykata per ceshtjet penale per subjektin, administratorin, ortaket dhe aksioneret - paragrafi i dyte.

3- Vertetim nga prokuroria per ceshtjet penale per subjektin, administratorin dhe ortaket dhe aksioneret - paragrafi dyte dhe i trete.

4- Vertetim i gjendjes gjyqesore per subjektin nga DPB ose e -albania.

5- Vertetim i gjendjes gjyqesore per administratorin, ortaket dhe aksioneret, nga e-albania

6- Vertetim nga gjykata per ceshtjet civile per subjektin - paragrafi i katert.

7- Vertetim nga tatimet per pagesen e tatimeve dhe sigurimeve - paragrafi i gjashte.

8- Vertetim per detyrimet e energjise elektrike (pershire muajin prill 2024), nga FSHU - paragrafi i shtate.

B- Ne perputhje me piken B te Pjeses IIIV - Kriteret e kualifikimit:

9- Vertetim per numrin e punonjesve te deklaruar (nqs ka deklaruar qe disponon punonjes), kontratat perkatese te punonjesve te deklaruar.

10- Dokumentacionin e mjeteve te deklaruar (nqs ka deklaruar qe disponon mjete).

*Nepermjet kesaj ankese, kerkojme Skualifikimin e OE GENERAL PLUS.*

*Gjithashtu per OE Biotek dhe OE ALMA KODRA, megjithese ne kolonen e katert te tabelës se klasifikimit te ofertuesve - arsye, per te dy keta OE shenohet: OE nuk ploteson kerkesen 2.4.4 te DT, pasi mostrat e paraqitura nuk jane sipas kerkesave te AK, cuditerisht ne kolonen e trete - refuzuar, shohim qe KVO ja perkatese NUK i ka refuzuar ofertat e ketyre dy OE. kerkojme refuzimin e ofertave te ketyre dy OE si dhe shtimin e arsyeve te refuzimit, pasi OE- Biotek dhe OE -ALMA KODRA, pervec se nuk plotesojne piken 2.4.4 te kerkesave per kualifikim te DT, gjithashtu nuk plotesojne piken 2.4.1 te kerkesave per kualifikim te DT. Kerkojme skualifikimin e OE - Biotek dhe OE - ALMA KODRA.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1740/2 date 01.07.2024, me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes pretendon, se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë fitues “General Plus” SHPK, “Biotek” SHPK dhe “Alma Kodra” PF.

II.7 Me shkresën nr. 209/15 prot, datë 03.07.2024, me objekt: “Kthim – përgjigje ankimit datë 01.07.2024” protokolluar me tonën me nr. 1740/3 datë 04.07.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar me arsyet si më poshtë vijon:

*Përsa i përket ankesës suaj datë 01.07.2024, mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje rrota për kazan”, me fond limit 1.702.800 lekë pa tvsh, autoriteti kontraktor pasi mori në*

shqyrtim ankimin tuaj ju komunikojmë se referuar kualifikimit të OE General Plus, në përfundim të vlerësimit të ofertave dhe duke qenë se operatori me ofertën më të ulët plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat e parashtruara në dokumentat standarte të garës i është kërkuar paraqitja e dokumentave origjinale ose të njehësuar me origjinalin. Me dorëzimin e dokumentave të kërkuara operatori ekonomik i kualifikuar, me ofertën më të ulët pasi rezultojë se përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktorësh kryer shpallja e fituesit. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga OE General Plus rezulton se ajo përmbush të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor dhe për këtë arsye ankimi juaj për skualifikimin e këtij operatori nuk pranohet. Përsa i përket pretendimit për skualifikimin e operatorëve Biotek dhe Alma Kodra për shkak se sistemin elektronik figuron deklarimi që këta operator nuk plotësojnë kërkesën 2.4.4 ju informojmë se ky deklaram është kryer për shkak të një gabimi teknik të një prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe jo nga të tre anëtarët. Gjithashtu edhe nëse nuk do të bëhej fjalë për një gabim teknik përsëri oferta do të konsiderohej e vlefshme duke qenë se dy anëtarët e tjerë të komisionit e kanë konsideruar ofertë të vlefshme pasi plotësonion të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor. Gjithashtu rezulton se operatorët ekonomik plotësojnë edhe kriterin 2.41. Për këtë arsye pretendimi për skualifikimin e ofertave të operatorëve Biotek dhe Alma Kodra nuk pranohet. Për sa më sipër, autoriteti kontraktor ju njofton për mospranimin e ankimit.

II.8. Më datë 08.07.2024, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar me shkresën nr. 1740/4 prot, formulari i argumentave nga subjekti i interesuar “General Plus” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.9. Me shkresën nr. 1740/5 prot, datë 29.07.2024 me objekt: “Kërkesë për dorzim mostrash”, Komisioni Prokurimit Publik ka kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dorzimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik General Plus” SHPK, “Biotek” SHPK dhe “Alma Kodra” PF, së bashku me dokumentacion përkatës dhe procesverbalin e pritjes së mostrave.

II.10. Me shkresën nr. 209/17 prot, datë 31.07.2024, me objekt: “Kthim – përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1740/6 datë 01.07.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor së bashku me mostrat e kërkuara në shkresën nr. 1740/5 prot, datë 29.07.2024.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, se operatori ekonomik Alma Kodra PF duhet të skualifikohet me argumentin se “[...] Ky operator ekonomik nuk

plotëson pikën 2.4.1 të kërkesave të tjera të veçanta për kualifikim[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.1 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” e ndryshuar, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet e ofruara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar si dhe katalogun ose skeden teknike të mallit. Në rast se një autorizim paraqitet nga distributori i autorizuar, lidhja, bashkëpunimi i kontratës / furnizimit, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit duhet të jetë e paraqitur me dokumentacionin përkatës.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Alma Kodra” ShPK, rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin si vijon:

- 1- Dokumentin “Autorizim Prodhuesi”, të lëshuar nga kompania prodhuese Guangzhou TX International LTD, me përmbajtje “*Ne shoqëria Guangzhou TX International LTD me adresë dhoma 661, ndërtesa nr. , rruga nr. 67 Gongyedadao EI, Rajoni Haizhu, Guangzhou, Kinë. Deklarojmë se autorizojm shoqërinë “Muça” shpk, Shqipëri me adresë Autostrada Tiranë Durrës, Km. 13, Tiranë Shqipëri si distributor të produkteve tona në Shqipëri. Muça shpk është e autorizuar të marrë pjesë në tendera dhe të realizojë kontrata me autoritetet publike dhe private në Shqipëri për rrota për kosha mbeturinash. Si distributor për produktet tona që fillojnë me shkronjën (CE) në faqen tonë të internetit, Muça shpk ka autoritetin për shitjet dhe pas shitjet. Autorizimi është dhënë më datë 28.05.2024 dhe ne Guangzhou TX International LTD, mund ta anulojmë këtë autorizim në çdo kohë. Ky autorizim është i vlefshëm deri më datë 31.12.2025”;*
- 2- Dokumentin “Autorizim Distributori” datë 12.06.2024, të lëshuar nga kompania “Muça” shpk me përmbajtje “*Shoqëria Muça shpk me nipt K01421002H, me adresë Autostrada Tiranë – Durrës km 13. Shoqëria Muça shpk është distributor kryesor i Guangzhou TX International LTD. Me anë të këtij autorizimi, autorizojmë Personin Fizik Alma Kodra, me nipt K32725211G, me adresë Lagjia Haxhias, Elbasan, të furnizohet me të gjitha mallrat e prodhuara (sistem rrotash të ndryshme për kazan) nga “Guangzhou TX International LTD”, me adresë rruga nr. 67 Gongyedadao EI, Rajoni Haizhu, Guangzhou, Kinë. Personi Fizik Alma Kodra është e autorizuar të japë ofertë, të negocjojë, të nënshkruaj kontratë për mallrat e ofruar nga ne dhe më pas të furnizohet me artikujt sistem rrotash të ndryshme për kazane etj, sipas preventivit dhe specifikimeve teknike për procedurën me objekt “Blerje rrota per kazane” me nr. REF-06297-05-23-2024, që do të zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor “Eco Tirana” sha nëse PF Alma Kodra shpallet fituese për këtë procedurë. Me këtë shkresë ne japim autorizimin tonë të plotë për PF Alma Kodra dhe të garantojmë për mallrat e ofruar nga shoqëria “Muça” SHPK.*

III.1.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.4. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*”

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet e ofruara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se një autorizim paraqitet nga distributori i autorizuar, lidhja, bashkëpunimi i kontratës / furnizimit, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit duhet të jetë e paraqitur me dokumentacionin përkatës”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Alma Kodra” PF, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin autorizim prodhuesi, si dhe autorizim nga distributori i autorizuar, ku pasqyrohet kompania prodhuese dhe të dhënat e identifikimit të saj. Pra nga sa më sipër rezulton e provuar se operatori ekonomik Alma Kodra PF pavarsisht se nuk posedon autorizim nga prodhuesi, ajo është paisur me autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi në rastin konkret nga shoqëria “Muça” SHPK (si distributor i autorizuar) nga prodhuesi “Guangzhou TX International LTD”, për të cilën ka paraqitur dokumentacionin që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Pra, operatori ekonomik “Alma Kodra” PF me dokumentacion e paraqitur përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.4.1 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit.



Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Alma Kodra” PF të kriterit 2.4.4 në kriteret e tjera të veçanta për kualifikim, konkretisht për specifikimet teknike, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këtë pretendim, operatori ekonomik ankimues, nuk parashton fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e kriterit 2.4.4 në kriteret e tjera të veçanta për kualifikim.

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë moster për çdo artikull sipas specifikimeve teknike të cilesuara nga autoriteti kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.*

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

|                       |  |             |            |
|-----------------------|--|-------------|------------|
| <i>Rrota me frena</i> | <i>Strukture hekuri zingato me kuzhiniere, Diametri i rrotes 200 mm, Trashesia e rrotes 50 mm, Pllaka e bashkengjitjes me gjeresi nga 110-120 mm, me gjatesi nga 135-145 mm Hapesira e fiksimit 105 x 80 mm, Frena me pedale, Kapaciteti i rrotes mbi 180 kg. Pesha e rrotes jo me pak se 3170 gr, Rrotat të jene me rrotullim 360 grade</i> | <i>cope</i> | <i>900</i> |
| <i>Rrota pa frena</i> | <i>Strukture hekuri zingato me kuzhiniere, Diametri i rrotes 200 mm, Trashesia e rrotes 50 mm, Pllaka e bashkengjitjes me gjeresi nga 110-120 mm, me gjatesi nga 135-145 mm, Hapesira e fiksimit 105 x80 mm, Kapaciteti i rrotes mbi 180 kg. Pesha e rrotes jo me pak se 3040 gr, Rrotat të jene me rrotullim 360 grade.</i>                 | <i>cope</i> | <i>900</i> |

III.2.3. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.2.4. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Alma Kodra” PF të kriterit 2.4.4 në kriteret e tjera të veçanta për kualifikim, konkretisht për specifikimet teknike, ankimuesi “Bajro Bros” SHPK duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim, pasi referuar specifikimeve teknike të shtojcë 5 të ndryshuar rezulton se për artikujt objekt prokurimi përbëhen nga disa specifikime teknike. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.5. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.7. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të

parashtrajnë pretendime a-priori duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.8. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Bajro Bros”, për mospërbushjen nga operatori ekonomik “Alma Kodra” SHPK të kriterit 2.4.4 në kriteret e tjera të veçanta për kualifikim, nuk merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Biotek” SHPK dhe “General Plus” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Alma Kodra” PF përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP-së do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Biotek” SHPK dhe “General Plus” SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt-prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedura e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-06297-05-23-2024, me objekt “Blerje rrota per kazane”, me fond limit 1.702.800 (një milion e shtatëqind e dy mijë e tetëqind) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

